



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2355/7 Prot.

Durrës, më 22.11.2024

V E N D I M

Nr. 70, Datë 27.11.2024

P Ë R

"MIRATIMIN E TARIFËS SË PROGRAMIT TË RI TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMIT BACHELOR "MENAXHIM MJEDISI", PRANË DEPARTAMENTIT TË SHKENCAVE INXHINIERIKE DHE DETARISË, NË FAKULTETIN E STUDIMEVE PROFESIONALE, TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës"

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 2, gërma b; neni 35 pika 1; neni 49; VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar; VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, "Për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; VKM-në nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; Udhëzimin MASR Nr.1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar; në Statutin e UAMD-së; Rregulloren e UAMD-së, vendimit të Senatit Akademik nr. 47, datë 26.11.2024, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I :

1. Miratimin e tarifës së programit të ri të ciklit të parë të studimit Bachelor "Menaxhim Mjedisi", pranë Departamentit të Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë, në Fakultetin e Studimeve Profesionale, të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.
2. Tarifa për këtë program studimi do të jetë 25.000 lekë/kredit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Administratori
 - Drejtuesi i Njesisë Kryesore
 - Drejtoria e Administrimit Financiar
 - Drejtoria e Kurrikulës dhe e Standardeve të Cilësisë

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Adi ALIAJ

